

Arsimi shqip në Komunën e Vitisë gjatë viteve 1905-1912

Tema e prezantuar

nga

Arjeta Shema - Arifi

pranë

Departamenti i Historisë

në plotësimin e pjesëm të obligimeve

për të fituar titullin

Master i Historisë

Shtator, 2022



Universiteti i Prishtinës

“ Hasan Prishtina “

Fakulteti Filozofik

Prishtinë

Komisioni i përbër nga:

Prof.Dr. Nuri Bexheti (Mentor)

Prof.Dr. (Kryetar)

Prof. Dr. (Anëtar)

Para se të filloj në paraqitjen e Ekspozes së temës, më lejoni ti falenderoj të gjithë ata që mundësuan në finalizimin e këtij punim.

Padyshim që një meritë të veçantë ka mentori im Prof.Dr. Nuri Bexheti i cili me vërejtjet, kritikën dhe sygjerimet e tyre profesionale, formësuan dhe fuqizuan këtë punim në nivelin shkencor. Falënderojë edhe anëtarët e komisionit të nderuarit Prof. Dr. Albina Dranqolli dhe Prof. Dr. Ibrahim Gashi për udhëzimet e dhëna profesionale me rastin e punimit të temës.

Një falënderim i singjertë u takon edhe atyre të cilët më ndihmuan të arrijë deri tek literatura e nevojshme dhe relevante si dhe dokumentet si orjentim dhe burime të kohës. Një falënderim edhe për personelin e Arkivave të Kosovës, Institutin Historik dhe Albanologjik, si dhe Arkivat nderkomanale dhe komunale në Gjilan dhe Viti, për gatishmërinë e tyre për të më lehtësuar punën time me këshillat e tyre profesionale dhe ofrimin të dokumentacionit relevant për periudhën kohore, ku këto burime më mundësuan që punimi të jetë më i kompletuar dhe më përmbajtësor.

Një falënderim edhe për kolegët e studimeve të cilët me këshillat, vërejtjet dhe sygjerimet e tyre kanë bërë që ky punim të jetë sa më cilësor dhe përmbajtësor.

Një falënderim të veçantë familjës sime, e cila ishte mbështetje e fuqishme në rrugëtimin tim.

Punimi im “*ARSIMI SHQIP NË KOMUNËN E VITISË GJATË VITEVE 1905-1912*”, ka një shtrukturë të gjerë dhe shumë përmbajtësore, duke filluar nga përmbajtja e cila ka një strukturë që plotëson të gjitha kriteret e një hulumtimi shkencor.

Punimi si i tillë posedon; Përmbajtjen, Abstraktin, Fjalet kyçe, Metodologjinë, Qëllimin dhe Objektivat, Hyrjen, tre kapituj, Konkluzionin, Burimet dhe Literaturën.

Në kapitullin e parë kam përfshirë; Shtrirjen Gjeografike të Komunës së Vitisë dhe fshatrave që dhanë një kontribut të madh në emancimin e gjendjes së arsimit në këtë lokalitet, pastaj pozicionimin e shqiptarëve në përgjithësi po të anamoravës në veqanti karshi Revolucionit Xhon - Turk dhe shqiptarëve, e krejt në fund Represionin Serbo Malazez në fshatrat e Komunës së Vitisë, duke i hulumtuar dhe i nxjerrur disa të dhëna shumë të rëndësishme të masakrave dhe luftërave në përgjithësi të kësaj ane të Kosovës, të lënë anash edhe nga institucionet shtetërore.

Në kapitullin e dytë përfshihen shkollat e para shqipe në Komunën e Vitisë dhe gjendja e arsimit në këtë komunë, duke filluar Shkolla e Stubllës, si shkolla e parë shqipe në Komunën e Vitisë dhe në tërë territorin e Kosovës, që nga viti 1905, pastaj Librat e përdoruar dhe lëndët mësimore, Hapja e shkollës shqipe në fshatin Pozheran, nga viti 1909, Dita e parë e shkollës në Pozheran ngjarje e madhe për arsimin kombëtar në Anamoravë e më gjerë, Historiku dhe ndërtimi i shkollës parë shqipe në Pozheran, e krejt në fund të kapitullit trajtohet, të dhënat historike për ndërtimin e shkollës në Pozheran.

Në kapitullin e tretë jam munduar të trajtoj, Objektin e tanishëm të shkollës së parë shqipe në Stubëll, tani si shtëpi muze, pastaj ndihmen që kishte nga AustroHungaria për shkollën shqipe në Stubëll, Veprimtaria Hasan Prishtinës për shkollat shqipe në Anamoravë veçënisht në fshatin Pozheran.

Punimi im ka gjithashtu edhe Qëllimin, objektivat dhe metodologjinë

Qëllimi kryesor i këtij punimi është që të paraqes një edhe disa detaje më shumë lidhur me shkollën shqipe në Anamoravë, personalitetet dhe mësuesit e parë, si Dom Mikel Tarabulluzi dhe Sylejman Salihun (Mulla Sylën) dhe dhe ngjarjet e mëpastajme që e shoqëruan shkollën shqipe dhe gjendjen e shqiptarëve në këtë lokalitet.

Përveç literatures në këtë punim dua të prezantoj ngjarjet edhe në bazë të dokumenteve arkivore dhe dokumenteve të ndryshme nga personalitet më të shquar të arsimit mbarëkombëtar të asaj kohe. Kurse metodologjia sa më efikase është ndër procedurat më të rëndësishme të punës në trajtimin e kësaj teme. Prandaj, ajo duhet të jetë e përshtatshme për qëllimin dhe synimin e jo anasjelltas. P.sh në disa raste të hulumtimit janë sistematikisht të praktikuara analizat e diskursit, të cilat më kanë hyrë në punë për të zgjeruar horizontin e ngjarjeve dhe aspektit të studimit të tyre.

Në hulumtimin tim dhe gjatë punës për këtë temë, jam mbështetur në metodologjinë e hulumtimit sistematik në arkiv, duke grumbulluar të dhëna nga literatura dhe dokumente arkivore. Por jam përpjekur që përmes metodës së bisedimeve direkte me persona që janë në ngjarje me sistemin e arsimit dhe të marrë vetëm pikat kyqe dhe pastaj të seleksionoj ato ashtu siç kërkohet që ky punim të jetë sa më gjithëpërfshirës dhe i plotë.

Si kriter të parë të metodologjisë kam caktuar grumbullimin e të gjitha burimeve të vlefshme për punimin që të jetë shkencëtarisht i vlefshëm.

Kriteri i dytë ka të bëjë me diciplinën më të përshtatshme për hulumtimin e burimeve historike. Kriteri i fundit ka të bëjë me ndjeshmërinë personale që dokumentet të trajtohen si dëshmi historike pa u ndikuar nga faktor të ndryshëm.

Kështu në metodologjinë e punës që kam përdorur jam përpjekur që të bëj dallimin mes ngjarjes në tërësi, se si është përshkruar deri tash dhe një këndvështrimi im si hulumtuese e re.

Punimi im, bazë dhe qëllim ka përdorimin e metodës kualitative në kuptimin një cilësie të lartë dhe ku njëkohësisht do të përfshihen burime arkivore dhe argumente më kredibile, si dhe të dhëna nga autorë shumë të shquar dhe eminent. Referencat, pikërisht do të përfaqësojnë botime të ndryshme, që paanshëm trajtojnë këtë problem, pastaj institucione dhe artikuj shkencor të ndryshëm dhe relevante.

Punimi gjithashtu ka edhe përfundimin dhe Burimet dhe Literaturën, për të cilat nga çdo burim dhe fusnotë janë referencat dhe botimet.

